

Hapet thirrja për aplikime për studentët Ph.D. të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Granadës, në Spanjë, në kuadër të Programit Erasmus +, për semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët Ph.D. të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Granadës, në Spanjë për semestrin e dytë për vitin akademik 2019-2020.

<https://www.ugr.es/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- PhD;

Kohëzgjatja e bursave:

- PhD (3 muaj);

Fushat e studimit:

Klikoni linkun: <https://internacional.ugr.es>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (850 EUR në muaj për studentët);

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit PhD:

-CV (në gjuhën angleze/spanjolle);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studentit (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose spanjolle);

-Listë notash e nivelit PhD (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose spanjolle);

- Diplomë e nivelit Bachelor dhe Listë notash (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose spanjolle);

- Diplomë e nivelit Master dhe listë notash (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose spanjolle);

-Plani i kërkimit mbi tezën e PhD (i cili duhet të firmoset nga pedagogu udhëheqës në UT dhe nga një pedagog në Universitetin e Granadës), sipas linkut:

<http://internacional.ugr.es/pages/perfiles/estudiantes/ka107inphdresearchplanshortstaysplande trabajo>

-Letër Motivimi në gjuhën angleze/spanjolle;

- Letër pranimit paraprake, nga një profesor në universitetin pritës, sipas linkut:

http://internacional.ugr.es/pages/preadmissiondoctoradoka107_in

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B2/Spanjisht B2);

Për t'u njohur me Gjuhët e Huaja që pranohen nga Universiteti i Granadës referohuni linkut:

<https://internacional.ugr.es/pages/politica-linguistica/tablasdecertificadosaceptadosporlaugr>

-*Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët (temën e kërkimit) që do të zhvillojë në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët/tema e kërkimit dhe kreditet që do të marrin në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se si do të njihen në Universitetin e Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit, lëndët/tema kërkimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Granadës lëndë/ temë kërkimi të njëjtë me ato që do të kryeni në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët/tema e kërkimit dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni.

Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing.docx

Afati për aplikime për bursa: 18 Nëntor 2019

Dokumentacioni duhet dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të kontaktoni me Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën e e-mail: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!